



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIJË
DHE ENERGJISË

Nr. 398/prot

Tiranë, më 29.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1439, datë 01.10.2009.

SHOQËRISË "DOKU - P" SH.P.K
Lagjia nr.1, Krujë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "DOKU - P" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1439, datë 01.10.2009, për mineral brekçie shpatë, në objektin "Mukje, Krujë", në Qarkun Durrës.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.5818, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5398, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1439, datë 01.10.2009, për mineral brekçie shpatë, në objektin "Mukje, Krujë", në Qarkun Durrës, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit në shumën 337 641 lekë siç është përcaktuar në nenin 31, pika 5, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, për vitet 2014 – 2015, 2015 -2016 dhe 2016 – 2017.

Leja juaj është dhënë në bazë të Ligjit nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar që është shfuqizuar me Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gjurmën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për

të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1439, datë 01.10.2009, për mineral brekçie shpati, në objektin "Mukje, Krujë", në Qarkun Durrës, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1439, datë 01.10.2009, për mineral brekçie shpati, në objektin "Mukje, Krujë", në Qarkun Durrës.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën kenë ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

